



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT// OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/



Znj. Edona Hajrullahu, Shefe
ekzekutive, Agjencia për Barazi
Gjinore/Zyra e Kryeministrit,
Kosovë



Z. Klaus Feiler, Sekretar i
Shtetit, Dep. i Financave i
Senatit, Berlin, Gjermani



Znj. Mimoza Kusari-Lila,
zëvendëskryeministre, duke iu
adresuar konferencës ndërkombëtare
“Buxhetimi Përgjegjës
Gjinor: Sfidat dhe Praktikë”



Znj. Catharina Schmitz, Drejtore
Ekzekutive e Interdevelop. Nga
Suedia



Znj. Alida Tota, Drejtore për
Mundësi të Barabarta dhe
Politika të Familjes— Sektori
për Mundësi të Barabarta dhe
Masa ndaj Dhunës në Familje

Konferenca Ndërkombëtare:
“ Buxhetimi Përgjegjës Gjinor: Sfidat dhe Praktikë”
Prishtinë, Kosovë, 15 Nëntor 2012

Hyrje

Çështja e barazisë midis burrave dhe grave ka tërhequr vëmendje të madhe në nivel qendror dhe lokal. Ndarja e drejtë e buxheteve komunale konsiderohet të jetë një çështje e rëndësishme për t'i shtyrë përpara proceset sociale, ekonomike dhe demokratike në Kosovë. Kohëve të fundit, vendimmarrësit me mbështetje nga donatorë të ndryshëm ndërkombëtarë, po hulumtojnë qasje të reja për ta theksuar çështjen gjinore. Prandaj, buxhetimi përgjegjës gjinor (BPGJ) është një qasje e re për ta luftuar pabarazinë gjinore dhe për t'i plotësuar si duhet nevojat e burrave dhe grave duke i përfshirë ato në politika publike.

Republika e Kosovës e ka legjislacionin të përshtatshëm dhe te mjaftueshëm që garanton barazinë gjinore dhe mundësitë e barabarta. Megjithatë, pabarazia gjinore për të pasur qasje në burimet financiare dhe në shpenzimin e fondeve publike është sfiduese. Prandaj, Agjencioni për Barazi Gjinore i cili funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës ka organizuar konferencën ndërkombëtare për buxhetimin përgjegjës gjinor.

Synimet e konferencës:

- Të ofrojë informata për praktikë më të mira dhe të zgjerojë njohuritë për buxhetimin përgjegjës gjinorë në nivel lokal dhe qendror.
- Të shkëmbejë instrumentet dhe udhëzimet e përpiluara për mënyrën si të zbatohet buxhetimi përgjegjës gjinor në nivel lokal.

Folësit kyçë

Konferenca kishte folës kyçë nga Kosova dhe jashtë saj:

- Edona Hajrullahu, *Shefe Ekzekutive, Agjencia për Barazi Gjinore/Zyra e Kryeministrit, Kosovë*
- Klaus Feiler, *Sekretar i Shtetit, Departamenti i Financave i Senatit, Berlin, Gjermani*
- Catharina Schmitz, *Drejtoresh Ekzekutive në Interdevelop nga Suedia*
- Alida Tota, *Drejtoresh për Politika dhe Mundësi të Barabartë dhe Familje - Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta, Shqipëri*
- Celestine Krösschell – *HELVETAS Zvicerran*
- Avni Kastrati– *Kryetar i Komunës së Mitrovicës*
- Melihate Limani, *Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive e USAID-it*
- Zana Plakij, *Udhëheqëse e Grupit të Grave, Graçanicë*
- Mubexhel Zhuri, *Zyrtare Gjinore, Prizren*
- Zejnije Lenjani – *Zyrtare Gjinore, Kamenicë*

Pjesëmarrësit

Konferenca u ndoq nga më shumë se 150 pjesëmarrës nga institucionet qendrore dhe lokale të Kosovës, sektori i shoqërisë civile, donatorët ndërkombëtarë dhe mysafirë të tjerë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/

Konferenca: Konkluzionet dhe Rekomandimet

Sfidat e Identifikuara:

1. Buxhete që pasqyrojnë perspektivën gjinore (duke përfshirë aspektin gjinor në rrjedhat e përgjithshme ndërsektoriale)
2. Të dhëna të disagreguara gjinore dhe analiza gjinore.
3. Pjesëmarrja e grave në procese vendimmarrëse
4. Bashkëpunimi në mes të grave të nivelit lokal dhe qendror
5. Bashkëpunimi i grave nga parti të ndryshme politike
6. Zbatimi i ngadalshëm i ligjeve (sidomos i atyre që ndikojnë çështjet gjinore)
7. Punësimi i grave
8. Fuqizimi ekonomik i grave
9. Edukimi i grave në zonat rurale
10. Qarkorja buxhetore që pasqyron perspektivën gjinore

Konkluzionet:

1. Buxhetimi gjinor është një koncept i ri për institucionet dhe shoqërinë e Kosovës, kështu që zbatimi është i ngadalshëm
2. Mekanizmat institucional mund të fuqizohen duke pasur linja të qarta buxhetore. Të gjitha institucionet duhet të jenë përgjegjës për buxhetimin përgjegjës gjinor.

Rekomandimet:

1. Buxhetimi gjinor duhet të zbatohet me ligj.
2. Para miratimit të buxheteve lokale dhe qendrore të bëhen auditimet gjinore
3. Ndarja e buxhetit të targetuar për çështje gjinore në nivelin lokal (duke përfshirë çështjen gjinore në rrjedhat e përgjithshme ndërsektoriale)
4. Analiza gjinore është e nevojshme për të përcaktuar ndikimin e buxhetit për burrat dhe gratë
5. Hartimi i indikatorëve kyç për të matur progresin e barazisë gjinore në nivelin lokal dhe qendror
6. Ngritja e përfshirjes së grave në procese politike në nivel lokal
7. Të vazhdohet me aplikimin e kuotave për përfaqësim gjinor
8. Ngritja e bashkëpunimit mes grave të nivelit Lokal dhe qendror duke lënë anash orientimet politike
9. Realizimi i zbatimit të ligjeve (sidomos i atyre që ndikojnë në çështjet gjinore)
10. Ngritja e vetëdijësimit të grave dhe burrave për barazinë gjinore
11. Ngritja e kapacitetit të grave në fusha specifike
12. Ngritja e bashkëpunimit mes grave dhe organizatave joqeveritare
13. Grumbullimi i më shumë të dhënave gjinore, realizimi i analizave gjinore dhe shfrytëzimi i të dhënave dhe analizave të tilla gjatë hartimit të politikave lokale/qendrore



Znj. Celestine Krösschell –
HELVETAS Zvicerran



z. Avni Kastrati, Kryetar, prezantoi praktikat dhe sfidat e buxhetimit përgjegjës gjinor në Komunën e Mitrovicës



znj. Mubexhele Zhuri, Zyrtar Gjinnor, prezantoi praktikat dhe sfidat e buxhetimit përgjegjës gjinor në Komunën e Prizrenit.



Zsh. Zana Plakiq, prezantoi praktikat dhe sfidat e buxhetimit përgjegjës gjinor në komunën e Graçanicës.